



**Qeveria e Republikës së Kosovës
Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës**

Republika e Kosovës / Republika e Kosovës / Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo	
MINISTRIA E INDUSTRIJË, TREGTISË DHE TREGTISË / MINISTARTVO INDUSTRIJE, TRGOVINE I VA TRGOVINE / MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE / AGENCIJA ZAPOSLOVANJE IZPOSLOVANJE IZPOSLOVANJE REGISTRATION AGENCY, GENERAL AGENCE D'ENTREPRENEURSHIP	
Nr. Prot. / Org. Unit:	11
Nr. Prot. / Org. Unit:	512
Data / Date:	05.11.2025
PRISHTINË	

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI



**Agjencia për Administrimin e
Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar**

Republika e Kosovës / Republika e Kosovës / Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo	
Ministria e Drejtësisë, Ministria e Prokurorisë / Ministry of Justice Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar Agency for the Management of Seized Assets	
Nr. Prot. / Org. Unit:	01
Nr. Prot. / Org. Unit:	540
Data / Date:	05.11.2025
PRISHTINË	

Me datë 05.11.2025, lidhet Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Palëve:

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (më tutje AAPS), me adresë, Ndërtesa e Qeverisë, Rr. Luan Haradinaj, pn. Ndërtesa e ish Rilindjes, Prishtinë, përfaqësuar nga u.d Drejtori i Përgjithshëm, z. Alban Sutaj.

dhe

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (më tutje: ARBK), me adresë, Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" p.n. Prishtinë, përfaqësuar nga znj. Igballe Rexha-Jashari – u.d. Drejtore Ekzekutive me autorizimin me nr.Ref. 01/Nr.79 të datës 24.10.2025 të lëshuar nga z. Mentor Arifaj zv. Ministër në detyrë i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Nr. Prot. 512
Kopje nr. 1
Afati i ruajtjes _____

Nr. Prot. 540
Kopje nr. 1
Afati i ruajtjes _____

Neni 1

Qëllimi

1. Ky Memorandum lidhet me qëllim të forcimit të bashkëpunimit në mes dy institucioneve, për të mbështetur njëra tjetrën në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në kuadër të kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore.
2. Ky memorandum është arritur mbi bazën e nevojave të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, bazuar në domosdoshmërinë e përmbushjes së mandatit dhe misionit të saj kushtetues dhe ligjor.
3. Për atë që u tha më sipër, palët bien dakord të respektojnë qëllimin e këtij Memorandum Bashkëpunimi si më poshtë.

Neni 2

Baza Ligjore

Ky Memorandum bazohet në nenin 4, paragrafi 1, pika 1.13 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe dispozitat e Ligjit nr.06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Fushëveprimi

1. Ky Memorandum vendos natyrën dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (më tutje: ARBK) dhe AAPSK.
2. Ky Memorandum po ashtu vendos procedurat, kushtet dhe kriteret për lehtësimin e procedurës së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës dhe AAPSK.
3. Dispozitat e këtij Memorandumi, përcaktojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet për palët kontraktuese.

Neni 4

Obligimet e ARBK

1. Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës merr përsipër që të ndajë me Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, qasjen në data bazat e saj sipas kërkesës të bazuar në nevojat e AAPSK.
2. Në kuadër të kapaciteteve të veta trajnuese dhe profesionale, ARBK do ta mbështesë AAPSK në ngritjen e profesionalizimit nëpërmjet trajnimeve specifike, seminareve apo në forma tjera të shkëmbimit të përvojave.
3. ARBK do t'i ofrojë AAPSK-së mbështetje, duke i lejuar qasje në data bazat që menaxhon, me qëllim të marrjes së të dhënave për bizneset që operojnë në Republikën e Kosovës.

4. ARBK obligohet që të njoftoj AAPSK në lidhje me rifreskimin e data bazës dhe të merr përsipër mirëmbajtjen e tyre.

Neni 5 **Obligimet e AAPSK**

1. AAPSK obligohet që të marrë masat e duhura për mënyrën e përdorimit të data bazës përfshirë dhënien e orientimeve me qëllim të mbrojtjes nga qasja e personave të paautorizuar.
2. AAPSK obligohet që të mbajë takime me personin e autorizuar nga ARBK, varësisht nga nevoja për fushë veprimtarinë të cilat janë në interes të sigurisë së Kosovës.
3. AAPSK obligohet që përdorimin e data bazës ta bëjë në përputhje me obligimet ligjore që derivojnë nga ligji për mbrojtjen të dhënave personale dhe vetëm për qëllimin e ushtrimit të mandatit ligjor të saj.

Neni 6 **Personat kontaktues**

1. ARBK dhe AAPSK do të caktojnë personat kontaktues të cilët do të jenë përgjegjës për të siguruar zbatimin dhe funksionimin e dispozitave të këtij Memorandumi .

Neni 7 **Shkëputja dhe ndryshimi i memorandumit**

1. Secila palë ka të drejtë të shkëpus këtë Memorandum në çdo kohë duke e paralajmëruar palën tjetër me shkrim në një afat kohor prej 30 ditësh.
2. Palët pajtohen në çdo kohë për ndryshimin ose plotësimin e këtij Memorandumi, varësisht nga nevojat e tyre dhe zhvillimet në terren.
3. Të gjitha ndryshimet ndërmjet Palëve, të cilat lindin nga interpretimi, zbatimi ose aplikimi i cilitdo aspekt të këtij Memorandumi mund të zgjidhen me konsultim të ndërsjellë pa referencë ndaj as një pale të tretë apo gjykate.

Neni 8 **Zgjerimi i bashkëpunimit**

Palët pajtohen që në çdo kohë të zgjerojnë bashkëpunimin e tyre edhe në çështje të tjera që nuk përcaktohen në këtë Memorandum, dhe që janë në kuadër të kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore.

Neni 9

Mbrojtja e të dhënave personale dhe informacioneve të tjera

Palët pajtohen që në kuadër të bashkëpunimit të tyre do të respektojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacioneve të tjera që burojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi.

Neni 10

Kopjet e Memorandumit

Ky Memorandum nënshkruhet në katër kopjetë njëjtë, nga dy kopje për secilën palë.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga të dyja palët.

Palët nënshkruese

Për Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve
të Kosovës

Për Agjencinë për Administrimin e Pasurisë
së Sekuestruar dhe Konfiskuar



znj. Igballe Rexha-Jashari
u.d.Drejtores Ekzekutive, Agjencia
Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
Sekuestruar





z. Alban Sutaj
u.d Drejtor I Përgjithshëm, Agjencia
për Administrimin e Pasurisë së
dhe Konfiskuar



Prishtinë, datë: 05.11.2025